

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“DREAM COSTRUZIONI GENERALI” Sh.p.k

KREU I

Neni 1

Krijimi

Shoqeria “**DREAM COSTRUZIONI GENERALI**” Sh.p.k., eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”).

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKR, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria “**DREAM COSTRUZIONI GENERALI**” Sh.p.k., është një shoqëri tregtare, e themeluar nga 2 (dy) ortake, te cilet nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojne personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakeve përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.


Kapitali i shoqerise 350.000(Ter qind e pesëdhjetë mijë /ALL).

Secili ortak zoteron një kuote te vetme ne shoqeri.

Neni 3

Selia

Shoqeria e ka seline ne adresen: Rr. “Andon Zako Cajupi”, Nd.6, Njesia Bashkiake nr. 5, Tirane, Shqiperi. Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te Asamblese se Pergjithshme.



Neni 4

Objekti i veprimtarise

Shoqëria do të zhvillojë aktivitet me objektin e mëposhtëm:

- Kryerja e punimeve rezidenciale ndërtimi dhe industriale në përgjithësi, duke përfshirë këtu veprimtarinë ndërtuese, prishjen e ndërtimeve, ristrukturimit, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e godinave dhe pasurive të paluajtshme, si ato rezidenciale po ashtu edhe ato tregtare dhe/ose industriale të çdo lloji, për veten dhe për të tretët;
- Blerje trojesh dhe ndarja e tyre në loto dhe urbanizimi i tyre për qëllime ndërtimi;
- Kryerja e punimeve të urbanizimit, gjërmimeve dhe lëvizjeve të dherave;
- Vepritmaritë e autotransportit të mallrave për llogari të të tretëve; blerja, shitja, shkëmbimi, dhënia me qira e pasurive të paluajtshme, për përdorim civil, industrial, bujqësor, dhe tregtare në përgjithësi;
- Tregtimi me shumicë dhe pakicë, i materialeve të ndërtimit dhe artikujve për ndërtim, dyshemenë dhe riveshjet, të mermerit, portave dhe pjesëve të dritates, të materialeve prej druri, bojëra dhe ngjyra, letër muri, artikuj hidrosanitare, artikuj prej hekuri, parafabrikate, soba dhe oxhaqe, dhe gjithësesi çdo material dhe/ose produkt për përdorim në sektorin e ndërtimit;
- Marrja me qira dhe dhënia për përdorim në favor të të tretëve (duke përjashtuar kontratat leasing) – në të gjitha format e lejuara – të vinçave dhe makinerive dhe pajisjeve për ndërtimin, gjithçka në përputhje me ligjet e këtij sektori;
- Shoqëria mund të zhvillojë të gjitha veprimtaritë ndihmëse të tregtisë, duke dhënë dhe duke marrë kontrata mandatuese, përfaqësësimi, shpërndarjeje, të agjencive, me ose pa magazinim, në lidhje me pasuritë e sipërtreguara.

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është ALL 350.000 (treqinde e pesedhjetemije leke)

Pjesëmarrja e ortakëve themelues në kapitalin themeltar është në përpjeksim me kontributin e tyre si më poshtë:

Z. Guglielmo Abbate zotëron 1 (një) kuotë të vetme në shumën ALL 175.000 (njeqinde e shtatedhjete e pesemije leke) e cila përfaqëson 50 % të kapitalit të shoqërisë.

Z. Giorgio Scardoni zotëron 1 (një) kuotë të vetme në shumën ALL 175.000(njeqinde e shtatedhjete e pesemije) e cila përfaqëson 50 % të kapitalit të shoqërisë.

Kontributi i ortakeve eshte në para dhe eshte paguar teresisht.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- d) dhurimit;
- e) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te tij ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr.



9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8


Organi Vendimmarres

Asambleja e Pergjithshme eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Pergjithshme eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike;
- f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet o tjera ndaj administratorëve;
- k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.



Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi jepet ne forme shkresore vetem per një mbledhje te asamblese se përgjithshme dhe eshte i vlefshem edhe per mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

Neni 9

Administrimi

1. Asambleja e ortakëve emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Koëgjzta në detyrë është 5 vjet me të drejtë rinosimi. Emërimi i administratorëve prodhon efektet pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Personat e mëposhtëm emërohen në cilësinë e administratorit të shoqërisë, së bashku ose veçmas:

Z. Guglielmo Abbate, i biri i Giuseppe-s, shtetas italian, lindur me 23/01/1973 në Modica (Itali) dhe banues në Monzambano (Itali) ne adresen: Via Borsellino n 15, mbajtës i kartës së identitetit nr. AU 2460730, lëshuar nga Komuna e Monzambano (Itali) me 25/06/2014

Z. Giorgio Scardoni, i biri i Carlo-s, shtetas italian, lindur me 02/05/1962 në Verona dhe banues në Povegliano Veronese në Verona(Itali) me adresë: Via Dossetto, n. 35 Itali, mbajtës i kartës së identitetit me nr. AS 2143730, lëshuar nga Komuna e Povegliano Veronese-s më 28/09/2011 .

Neni 10

Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;



- d) përgatisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) krijoje një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryejë regjistrimet dhe te dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- g) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori eshte i detyruar te therrase Asamblene e Pergjitheshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 % të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 % të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 11

Viti Financiar

Viti finansiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare finansiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKR dhe mbyllte me 31 Dhjetor.



Neni 12

Prishja dhe likuidimi i shoqerise

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet :

- a) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
- b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
- c) në rast se objekti bëhet i parealizueshëm për shkak të mosfunkcionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
- ç) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 i Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 I ndryshuar;
- d) në raste të tjera, të parashikuara në statut;
- dh) në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
- e) për çdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e ortakëve.

Ne kete rast asambleja e pergjithshme merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Neni 13

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete akt themelimi dhe dispozitat e legjisacionit shqiptar ne fuqi.

Per sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e statutit, ligjit nr. 9901, date 14/04/2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" i ndryshuar, kryesisht nenet 68-104, te Kodit Civil te RSH, nenet 24-38(Kreu II) ,te Ligjit nr.9723, date 03/05/2007" Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" i ndryshuar, nenet 22,28,32,35 e ne vijim si dhe te çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.



Ky Akt Themelimi nenshkuhet rregullisht nga ortaket e shoqerise, para meje noteres dhe une
Noterja pasi e gjej te rregullt vertetoj nenshkrimet e tyre ne baze te ligjit.

O R T A K E T
E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“DREAM COSTRUZIONI GENERALI” SH.P.K.

Z. Guglielmo Abbate

ABBA
GUGLIELMO
Abb
W
PERKETHYESI
ALBAN DAUTI



Z. Giorgio Scardoni

Giorgio Scardoni
Gjig Scardoni

26.10.2016